

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

MIRATOHET

K R Y E T A R I

**Gramoz RUÇI**

**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MEDIAVE  
AUDIOVIZIVE PËR VITIN 2020**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke njohur AMA-n si një institucion të pavarur dhe autoritet rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë;

Duke vlerësuar që reagimi i OSHMA-ve ka qenë i menjëhershëm dhe efikas në zbatim të kërkesave ligjore për rastin e pandemisë së COVID-19, duke përcjellë disa herë në ditë mesazhet e përgatitura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Duke vlerësuar se finalizimi me sukses i procesit të digjitalizimit në Republikën e Shqipërisë ka sjellë shërbim më cilësor dhe numër më të madh kanalesh pa pagesë për qytetarët;

Duke vlerësuar se finalizimi me sukses i procesit të digjitalizimit në Republikën e Shqipërisë i ka hapur rrugën futjes së teknologjive të reja në fushën mobile, ofrimit të shërbimeve të reja inovative, me cilësi më të lartë për qytetarët,

**Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) në këto drejtime:**

- Punën e bërë nga AMA gjatë pandemisë së COVID-19 për nxitjen dhe ndërgjegjësimin e OSHMA-ve, që të ishin bashkëpunuese me autoritetin shëndetësor publik në transmetimin e mesazheve informuese për qytetarët dhe institucionet, të nevojshme për parandalimin e përhapjes së koronavirusit.

- Reagimin e OSHMA-ve, i cili qenë i menjëhershëm dhe efikas në zbatim të kërkesave ligjore për rastin e pandemisë së COVID-19, duke përcjellë disa herë në ditë mesazhet e përgatitura nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në të njëjtë kohë thekson faktin që pandemia globale COVID-19 ka ndikuar në performancën e OSHMA-ve, duke dhënë efekte në strukturën dhe katalogun e përmbajtjeve të emetuara; në burimet njerëzore të angazhuara,

në treguesit ekonomikë dhe financiarë, ku u reduktuan ndjeshëm të ardhurat nga reklamat dhe promocioni etj.

- Punën e bërë nga AMA në ndjekjen dhe verifikimin në terren të situatës lidhur me problematikat e shfaqura të shtrimit të infrastrukturën numerike, pajisjes së qytetarëve me dekodera, si dhe situatës së pandemisë nga COVID-19, problematika të cilat çuan në shtyrjen e afatit të mbylljes së transmetimeve analoge në qarqet Shkodër, Lezhë, Vlorë dhe Elbasan deri më 30 shtator 2020. Në përfundim i gjithë procesi u mbyll me sukses më 30 shtator për të katër këto qarqe.

- Punën e bërë nga AMA për fushatën e informimit të qytetarëve, si dhe të ndjekjes dhe verifikimit në terren të situatës për mbylljen e sinjalit analog edhe në tri qarqet e mbetura të vendit, konkretisht: Kukës, Dibër dhe Gjirokastrë.

- Bërjen pjesë të buketës programore të RTSH-së kanal RTSH SHKOLLË si nevojë e detyrueshme e aplikimit të formateve të mësimdhënies në distancë dhe që i erdhi në ndihmë sistemit parauniversitar në rrethanat e krijuara nga efektet e pandemisë COVID -19 në sistemin arsimor të vendit tonë. Në të njëjtën kohë ky kanal për vetë natyrën e përmbajtjes së programeve të transmetuara, si dhe grupmoshës që i drejtohet, ka edhe atributet e një kanali të dytë për fëmijët.

- Nënshkrimin e disa marrëveshjeve të bashkëpunimit mes AMA-s dhe institucioneve të tjera, duke forcuar bashkëpunimin ndërinstitucional, me qëllim garantimin e mbrojtjes nga diskriminimi në fushën e shërbimeve audiovizive, si dhe respektimin, promovimin e të drejtave të fëmijëve në fushën e shërbimeve audio dhe/ose audiovizive.

### **Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) për vitin 2021 të angazhohet në këto drejtime:**

1. Pas finalizimit me sukses të procesit të digjitalizimit në Republikën e Shqipërisë, AMA të ndjekë në vijim shqetësimet e operatorëve lokalë, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të duhura të problematikave të ngritura nga operatorë lokalë.

2. Të japë kontributin e saj në procesin e transpozimit në legjislacionin kombëtar të Direktivës së BE-së 2010/13/BE “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, e cila ka pësuar ndryshime në fund të vitit 2018. Këto ndryshime, ndër të tjera, synojnë mbrojtjen më të mirë të të miturve, rregulla të reja për platformat online, ndryshime në rregullat e komunikimeve me natyrë tregtare.

3. Të vijojë të luajë një rol proaktiv dhe nxitës në arritjen e përmirësimit dhe të forcimit të mbrojtjes së të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve në sektorin audio dhe audioviziv, si një çështje e rëndësishme dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias, e cila nënvizohet edhe në raportin e progresit të KE-së.

4. Të ndjekë me ministrinë përgjegjëse dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë zgjidhjen e problemit të mungesës së interpretëve/përkthyesve për transmetimin me gjuhën e shenjave, dhe në të njëjtën kohë të kërkojë zbatimin e detyrimit ligjor për transmetimet me bazë gjuhën e shenjave nga operatorët audiovizivë me licencë kombëtare, si një detyrim që garanton të drejtën e informimit të komuniteteve me nevoja të veçanta shqisore.

5. Të japë kontributin e saj konkret në përafrimin me standardet ndërkombëtare të kërkesave ligjore për transparencën e pronësisë mbi mediat, financimin e mediave dhe kufizimet e tyre, problematika të cilat theksohen edhe në raportin e progresit të KE-së.

6. Të jetë pjesë aktive përmes propozimeve konkrete në diskutimet për ndryshimet ligjore të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar“, si për sa i takon krijimit të një kuadri rregullator për mediat online si një realitet i ri në në industrinë medietikë, ashtu edhe të adresimit të opinionit të Komisionit të Venecias për të bërë të mundur

që këto ndryshime të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe parimet e lirisë së medias.

7. Të punojë për zbatimin e rekomandimeve të papërbushura të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në mënyrë të veçantë rekomandimin lidhur me operacionet IT (*help desk*) për shërbimet e brendshme dhe të jashtme në fushën e sigurisë.

8. Të vijojë përpjekjet për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes AMA-s dhe AKEP-it për parandalimin dhe/ose ndalimin e piraterisë audiovizive online, duke pasur parasysh edhe realitetin e ri kur mediat, bazuar në internet, kanë një zhvillim të pandaluar dhe efekt të jashtëzakonshëm në industrinë mediatike,

9. Të japë kontributin e saj duke luajtur një rol proaktiv në përmirësimin e legjislacionit për reklamat publike për të bërë të mundur rritjen e transparencës në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, kërkesë e cilat theksohet edhe në raportin e progresit të KE-së.

10. AMA të luajë një rol nxitës dhe proaktiv në bashkëpunim me aktorët dhe faktorët përkatës duke bërë të mundur përmirësimet e nevojshme ligjore për një proces vetërregullimi, shqetësim i cili theksohet edhe në raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias.

Miratuar në datën 24.6.2021